



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



02 Nr. *060/04-51122* dt. *18/10/* 2024

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glogocit), neni 3 pika 3.7 si dhe neni 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Bekim Lestrani, më datë: **31.10.2024** (E enjte) duke filluar në ora **10:00** në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET
MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja do të ketë këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së jashtëzakonshme i Kuvendit Komunal Drenas të dt. 19.09.2024
2. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i Kuvendit Komunal Drenas të dt. 30.09.2024.
3. Propozim vendim për caktimin e anëtarëve të komisionit përzgjedhës për Drejtor në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore të Komunës së Drenasit
4. Draft Propozim Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2025-2029.
5. Raporti Financiar Janar- Shtator 2024.
6. Raport për implementimin e rekomandimeve që dalin nga Raporti i Auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Drenasit për vitin Fiskal 2023.
7. Të ndryshme.

Drenas, 18.10.2024



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Bekim Lestrani
Bekim Lestrani



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/04-51295 dt. 18/10/ 2024

PROCESVERBALI

I mbledhjes së jashtzakonshme të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: **19.09.2024** e cila filloi në orën **10:00**.

Mbledhjen e kryesoi anëtari më i vjetër i Kuvendit Komunal-Gani Krasniqi

Kryesuesi i mbledhjes deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së jashtzakonshme të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 30 anëtarë: Bekim Lestrani (PDK), Arigon Sinani (PDK), Zeqir Hasi (PDK), Laurita Muhadri Bujupi (PDK), Hamit Kastrati (PDK), Gani Krasniqi (PDK), Fatmir Baliu (PDK), Qendrim Mulaj (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Blerina Gashi (PDK), Kosovare Halilaj Karaxha (PDK), Valentina Leku (PDK), Manushaqe Mulaku (PDK), Mirlinda Dvorani (PDK) Sali Dvorani (DD), Mergim Pirraku (DD), Mehedin Salihu (DD), Hamit Haxhiu (DD), Jahir Hajdari (DD), Azemine Bujupi-Gjoka (DD), Marigona Bazaj (DD), Florentina Elezi-Veliu (VV), Filloreta Bujupi (VV), Selman Qallapeku (VV), Egzona Terrdevci (VV), Muhamet Kurtaj (VV), Arbër Halilaj (GREEN), Beqir Kiqina (AAK), Egzon Qorri (LDK), mungoi Labinot Halilaj.

Rend dite:

1. Propozim vendim për ndarjen e parcelës kadastrale 326-4 Çikatovë e Re.
2. Propozim vendim për Plotësim ndryshimin e Statutit të Komunës së Drenasit lidhur me emërtimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
3. Propozim vendim për miratimin paraprak të Vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës së Glogocit për shfrytëzim afatgjatë personave fizik/juridik (për 99 vjet)
4. Draft strategjia për Zhvillimin dhe fuqizimin e Rinisë në Komunën e Drenasit 2024-2029.
5. Raporti i punës Janar-Qershor 2024 i Kryetarit dhe qeverisjes lokale.
6. Raporti financiar Janar-Qershor 2024.
7. Diskutim i Raportit i Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) për vitin 2023.
8. Diskutim i Planit të Veprimit për Implementimin e Rekomandimeve të ZKA-së
9. Raporti i punës së KKSB-së Janar-Qershor.
10. Propozim vendim i Buxhetit të komunës për vitet 2025 dhe parashikimi i buxhetit për vitin 2026-2027.
11. Raporti i performancës komunale për vitin 2023 për komunën e Glogocit.

12. Propozim vendim për transfer/harmonizim në kategorinë e pagave.

13. Propozim vendim për ndryshimin e emrit të projekteve.

Të pranishëm ishin edhe **Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, nënkryetari i Komunës Arben Shala, Drejtor të Drejtorive komunale, zyra e informimit, përfaqësuesit e KFOR.**

Mbledhja e jashtzakonshme e Kuvendit të Komunës së Drenasit u mbajt me dt. 19.09.2024 ku për diskutim ishin 13 pika për rend dite. Mbledhja është kryesuar nga anëtari më i vjetër i Kuvendit Komunal, Gani Krasniqi. Kryesuesi i mbledhjes hapi punimet e mbledhjes se jashtzakonshmet të Kuvendit Komunal ku njoftoi me rendin e ditës:

Pasi që nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime Kryesuesi i mbledhjes Gani Krasniqi hodhi në votim rendin e ditës, prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar dhe votuan me: 17 vota (Për), 12 kundër dhe 1 abstenim.

Kryesuesi i mbledhjes, Gani Krasniqi- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. Propozim vendim për ndarjen e parcelës kadastrale 326-4 Çikatovë e Re.**

Pasi që nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime Kryesuesi i mbledhjes Gani Krasniqi hodhi në votim pikën e parë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar dhe votuan me: 28 vota (Për), 1 kundër dhe 1 abstenim.

Kryesuesi i mbledhjes, Gani Krasniqi- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **2. Propozim vendim për plotësim ndryshimin e Statutit të Komunës së Drenasit lidhur me emërtimin, kompetencat dhe përgjesisht e Drejtoris për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.**

Pasi që nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime Kryesuesi i mbledhjes Gani Krasniqi hodhi në votim pikën e dytë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar dhe votuan me: 29 vota (Për), 1 kundër abstenim nuk pati.

Kryesuesi i mbledhjes, Gani Krasniqi- hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Propozim vendim për miratimin paraprak të Vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës së Glllogocit për shfrytëzim afatgjatë personave fizik/juridik (për 99 vjet)**

Kryetari i komunës Ramiz Lladrovci- pasi përshëndeti të pranishmit, sipas listë që e përcakton për listën preliminare që komuna duhet ta miratoj në kuvend. Unë e kom sjell listën për miratim paraprak, kjo list nënkupton se komuna ka pronat e veta në territorin e saj që ban të ditur qytetarëve të vet, që i jep mundësi investitorëve të ndryshëm për zhvillimin e komunës me i pa, me i ba planet edhe me kërku që ata me këto prona me pas mundësi me investu. Gjithë kët numër të pronave që e kem para vetes që përfshin një sipërfaqe tepër të madhe prej 600 e më shumë hektarëve, janë pronë e komunës tonë e cila po mbahet vjerrin dhe komuna ka nevoj me pas një list preliminare sipas ligjit dhe sipas MAPL-së dhe ata ja ofron qytetarëve ne , i kemi edhe dy

faza tjera për me mund me i shpall edhe me ja jep ati që konkurron edhe që është me i miri që zgjidhet nga komisioni që mundet të zgjidhet nga asamblistë dhe zyrtarët e Komunës. kjo nuk nënkupton që këto pran jemi duke i qite ne raundin e dyte sepse ne mund ti paraqesim pronat të cialt jan me interes per investitorët.

Unë po ju them që ka investitor si për shembull në Gllanasell ,në kryqin e rrugës te varrezat në Likoshan, një kompani e rritjes se rosave që kan kerku 4 hekta dhe kan deklarë për një punsim prej 400 gra dhe vajza të zonës, po ashtu ka kërkesa prej kompanijave të tjera për ndërtimin e paneleve solare per energji të gjelbert, dhe dhjetra parcela të tjera që janë në interes të komunës dhe te zhvillimit dhe atyre që sjellin vende të reja të punës dhe te hyra për qytetarët e komunës tonë, unë nuk po du askujt me ia mbush mendjen me votu listën paraprake, ama askush nuk mundet me than që kom fol me dikon deri sot kur e kom taku grupin tim parlamentar dhe kemi diskutu kët temë që është shumë me rëndësi për zhvillimin e komunës. Grupi është unik dhe të ata që do ta mbështesin i falënderoj, kan kërku me i hjek tri prona ose tri pika të cilat jan në këtë list dhe sigurisht që do ti paraqes z. Milaim Hajdari dhe unë jom pajtu sepse nuk dëshiroj me blloku kuvendin sic e keni blloku ju me shkarkimin ekryesuesit që është një nga djemt më të mirë që i ka komuna jonë, një intelektual i jashtëzakonshëm, një luftëtar i UÇK-së prej vitit 1996 pse nuk keni pas çka me mban mua, as nuk keni me pas kurr, prandaj ju thërras që listën ta votoni mas propozimeve të ish kryesuesit Milaim Hajdari, ndërsa për mediat i kom nja tri kontrata rrugët kryesore rajonale, maxhistrale i jep prona me mbi 40 hektar për një qira vjetore bruto 128.80 € i keni tek unë kur të kryhet mbledhja.

Grupi parlamentar i PDK-së Milaim Hajdari- sot jem në mbledhjen e jashtëzakonshme dhe jem në piken e tretë që ka për qëllim mirtatimin paraprak të listës së pronave për dhënjën në shfrytëzim për 99 vite personave fizik dhe juridik, para se të bëj me dije se cila ishte kërkesa e grupit parlamentar të PDK-së që disa parcela të hiqen nga kjo list, vetëm diqka do të them që besoj që do të pajtohem i të gjithë. Ligji nuk e obligon kryetarin me i dhan pronat në shfrytëzim po ligji i jep të drejt kryetarit, e ka këtë të drejt ekskluzive me i dhën këto prona besoj që me këtë pajtohmi. Pajtohemi që sektori privat është shtylla e zhvillimit ekonomik të një vendi, zhvillimi ekonomik i një vendi determinon edhe ngritjen e standardit jetësor të njerëzve, gjithëqka përtej kësaj qfar kem para vetës në list unë nuk i jap vetës të drejt mund të mos ket interesa po është paragjykim, situatën që është kriju llafet e rrugëve, llafet e kafeve mund të jen të vërteta po ne nuk jemi pjes e saj, na e kemi për obligim që një list që e bjen ekzekutivi nuk ish dasht me diskutu janë procedura tjera. Po kujdesemi që brenda kësaj liste mos me kriju hapsir për konflikt interesi, pajtohemi unë kom qën në këtë pozit prej kësaj pozite të kryesuesit mu ka kërku që unë me votu kundër është absurde ulemi e bisedojm si kuvend është në dorën tonë a ka nevoj është fol për pronën prapa nesh ku është komuna e vjetër. Është dasht na me formu një komision, aj objekt ka vlera artistike, kulturore, historike, ka vlera që ju shërben qytetarëve tutje po jo prej nesh por jo prej nesh por prej ekspertëve të fushës me vlersu. Pajtohemi që ne e kemi një sallë të kulturës që e shfrytëzojmë në atë pjesë, objekti tërësisht është i pa riparueshëm, ne duhet me e dhën një ide, unë dha një ide, nëse vërtet qajo parcel duhet me u dhën në shfrytëzim sepse komuna nuk ka mundësi, nuk ka mjete me ndërtu një komunë atëher të gjithë duhet me qën të vetdijshëm ta krijojm këtyre qytetarëve një palestër me 1000 ulse, ky objekt që e kemi tani a mendoj që i plotëson kushtet për punë normale të administratës, jo në asnjë mënyr e dini ju si anëtar të kuvendit. Unë si kryesues kom punu tri vite me sekretarin në 16 m2 pesë punëtor katër drejtori janë 400 m2 të gjitha këto të gjithë mundeni me paragjyku të gjithë e dinë se kemi nevoj për një objekt të komunës, sidoqëjtet këto e shumë diskutime tjera që ndoshta edhe unë edhe

kolegët e mi të partis demokratike janë ndiku, kemi ardh në një përfundim se kryetarit iu jep të drejtën ligji ky e ka të drejt me pru listën e jona është me votu. Propozimi ka qen që këtu askush nuk ka interes përveç qytetarit të Drenasit është çek paraprakisht që një vitë ta hjekim parcelën e zona kadastrale në Gllogoc, ngastra kadastrale nr.1032/2, me sipërfaqe 5661 m², ngastra kadastrale 743-30, me sipërfaqe 8510 m², pjes e ngastrës kadastrale 768-1 me sipërfaqe 1970 m², po mos të ja pamundësojna investitorit tokën në Likoshan, Fushticë ose token dikuj tjetër. Unë kërkoj që të hiqën këto rti parcela prej liste e të vazhdojm tutje dhe ta votojm listën paraprake, ky është një hap i parë ne sot e kemi një gjithopinion, kuvendi don me i dhën pronat, kuvendi sot nuk i jep pronat, kuvendi sot miraton një list paraprake asnjë pron sot nuk e fiton askush, ne jemi ata që kishim mujt edhe hapin e fundit me ndal edhe mos me ia dhën po është kriju ky ambient edhe unë domethan duke i përfaqsu anëtarët e PDK-së të njëjtën koh edhe me vullnetin e kryetarit sepse nuk është qëllimi i kryetarit as i partis me pas interes këto tri parcela i hjekim edhe vazhdojm tutje

Grupi parlamentar i DD-së- Azemine Bujupi Gjoka- deshirojm të shprehim shqetësimin tonë të thell lidhur me disa nga pikat që sot ndodhen në kët rend dite. Sot jemi përball me një prej vendimeve më kritike që po ndikon drejtpërdrejt me të ardhmen e qytetit tonë dhe brezave që do të vin, qështja e pronave publike, është përgjesi e jona që ta trajtojm kët me kujdes maksimal jo vetëm për të qen në përputhje me ligjin dhe për të ruajtur integritetin tonë por edhe për të mbrojtur interesat e qytetarëve që na kan besuar kët detyr, le të themi qart dhe me bindje se dhënja në shfrytëzim për 99 vite e pronave publike është një akt që kupton analiz të thell dhe strategji të qart. Ne nuk mundemi ta miratojm një vendim të till pa një planifikim të strukturuar ku qdo pronë publike të ketë një destinuim të qart ku interesat e qytetarëve janë prioritet absolut. Ne propozojm klasifikimin e parcelave që janë të dedikuara për institucione publike në mënyr që ato të mbeten të pa prekura dhe të shërbejn për të mirën e përgjithshme të komunitetit, pronat me interes për invesitorët duhet të diskutohen veçmas duke i bauer vendimet në përfitime konkrete që sjellin vende të reja të punës që mund të krijohen, qfar logjike të transformojn prona publike që janë të destinuara për shërbimet e qytetarëve në duart e privatëve për të përfituar banesa dhe lokale afariste, si mund të justifikohet një vendim i till që mund të transformoj objektin komunal në një ndërtes banesore apo afariste, si mund të mendohet që një cërdhe e fëmijëve një institucion kyq për mirëqenjen e fëmijëve të zhduket për tu zëvendësuar me një objekt afarist apo që stacioni i autobusëve një element kyç për infrastrukturën dhe jetën e përditshme të qytetarëve të shëndrrohet në një pron private. Këto janë vendime që vetëm një mendësi e papërgjegjshme dhe që nuk ka interesin e qytetarëve në mendje që mund ti mbështes. Të dashur koleg këto prona janë jetike për qytetin dhe qytetarët tanë ato përfaqësojnë më shumë se sa thjeshtë parcela toke, ato janë themel i infrastrukturës sonë sociale dhe ekonomike këto prona duhet të ruhen për të ardhmen sepse jeta dhe nevoja e qytetit do të vazhdojn edhe më shumë pas nesh ne duhet të kërkojm zgjedhje më të mira më të qëndrueshme dhe më transparente duke pritur momente të duhura për investime publike në bashkëpunim me ministrin përkatëse e që këto prona të përdoren për të mirën e përbashkët dhe përfundimisht vendimet që marrim sot do ken një qëndrim të gjatë dhe të thell ne nuk guxojm të marrim vendime që mund të dëmtojn brezat e ardhshëm për përfitime të shkurtra të momentit, qëllimi ynë duhet të ndërtimi i një të ardhme më të mirë për qytetarët tanë, një të ardhme që është ndërtuar mbi bazat e qendrueshme të matur dhe të mirë kalkuluar

Grupi parlamentar i VV-së Egzona Terdevci- fillimishtë dua të shpreh zhgënjimin tim të thell dhe jo profesionalizmin me të cilin është trajtuar kjo pikë. Me dt.13.09.2024 kur u ftua kjo seanc na ishte dërguar një propozim vendim me vetëm emrat e parcerlav, pa skica, pa destinim të pronave që do të ipen, nga 59 prona sa na jan dërguar me dt. 13 shtator në propozimin e dërguar dje janë 54 prona, pra nga propozimi i javës së kaluar jan hequr 6 parcela dhe është shtuar një parcel e re. Nga parcelat e hequra dy prej tyre janë të Komoranit katër janë në Kishnarek dhe një parcel është shtuar në Çikatov e Vjetër në sqarimin e shkruar nga sekretaria thujet se bëhet fjal për një gabim teknik, por në kemi pranuar dy propozime vendime të ndryshme të shkruar në datën e njejt me nr. të njejt të protokollit, pra mbetet enigmatike heqja e parcelave në ditën e fundit, jemi dëshmitar se sa është manipuluar me pronën publike përgjat mandateve të Ramiz Lladrovci si Kryetar Komune, me premtime për shumë vende pune investime e për të hyra të mëdha komunale ishin dhën prona për shfrytëzim afatgjatë në mandatin e kaluar të kryetarit Lladrovci. Nëse shikojm të hyrat për viti 2021-2023 marr nga raportet financiare ato nuk tejkalojn vlerën e 216.000 € një shumë e pra një shumë tepër e pa përfillshme, në këtë kuvend përveç një raportimi të that e formal asnjëher nuk është raportuar siq duhet për pronat që janë dhën në shfrytëzim për 99 vite, a kan ndikuar vërtet ato prona në zhvillim ekonomik e në rritje të punsimit në Drenas apo kjo dhënje në shfrytëzim vetëm i ka shtuar fitimet e disave, është tëjet shqetsuse tëndenca për të dhën 54 prona në shfrytzoim afatgjat për 99 vite gjatë vitit 2024, por kjo nuk është e pa qëllimshme, një shpërdorim i pasuris publike po bëhet me qëllime shumë të qarta, shpagim i borgjeve të fushatës dhe përgaditje për zgjedhjet lokale të vitit 2025. Qeverisja e kësaj komune nuk e ka hallin as tëk zhvillimi ekonoomik e as të rritja e vlerës së këtyre pronave madje as tek punësimi, halli i tyre i vetëm është rritja e krinteles për zgjedhjet e ardhshme por ndoshta në një dimension edhe duhet mirëkuptu kryetarin, nuk ka punu nuk ka cka prezanton para qytetarëve e në këtë form don me fitu klientel që me i fitu zgjedhjet e ardhshme. Është përmend shumher në këtë kuvend por edhe jasht ti së ne po e pengojm zhvillimin e Drenasdit me mos votimin e këtyre pronave por as një her nuk janë prezantuar para nesh kërkesat e invesitorve qofshin vendor ose të huaj për këto prona, po e përjashtoj këtë të sodit se kjo ishte për shou më shumë asnjëher nuk ka pas një analiz të matshme për vlerën e këtyre pronave e vlerën që do ta kishin përmes dhënjes në shfrytëzim, ne si vetvendosje e kemi kundërshtuar dhe do të vazhdojm ta kundërshtojm dhënjen në shfrytëzim të pronave të palujtshme të Drenasit për shfrytëzim afatgjat për 99 vite sa her që bëhet fjal për diqka që nuk është në interes publik. Ne nuk kemi qen e nuk jemi asnjëher kundër zhvillimit ekonomik të komunës por dhënja e këtyre 54 pronave me pas një analiz të mirëfillt për 99 vite nuk i kontribuon këti zhvillimi. Ne i dim obligimet ligjore për miratimin paraprak të pronave që duhet të ipen në shfrytëzim por pikërisht duke u thirrur për këtë ligj konsiderojm se nuk jan plotësuar këto kushte, pra neni 5 ligji 6.92 për dhënjën në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së palujtshme të komunës thot se kriteret për shfrytëzim të pronës së palujtshme janë po e përmend njërin prej kriterëve. Të ket arsyshmëri të interesit publik apo përfitimit ekonomik të komunës. Arsyetimi një faqësh që na është sjell neve si asambleist nuk është aspak bindës për ti dhën për 99 vite 54 prona të qytetit tonë dhe për ne mbetet i pa pranushëm insistimi për të dhën secilën pron për 99 vite, në këtë form qytetit tonë nuk do ti mbesin toka për të realizuar projekte publike në të ardhmen. Për ne vetvendosjen është shqetësuse secila pronë nga lista e 54 pronave që do të jepen në shfrytëzim për 99 vite gjithëher duke mos pasur një analiz mirfillje që e paraqër përfitimin nga dhënja në shfrytëzim e këtyre pronave por në mesin e këtyre pronave ka prona që do të duhet të mbetëshin publike gjithnjë, e ka prona të cilat veq se shfrytëzohen edhe tash. Sot pam një vendim athok për tërheqjen e tri pronave i cili vërtet është i vlefshëm por z. Lladrovci duhet me spjegu para qytetarëve cila është

arsyeja që tash po tërhiqen, po filloj me tri pronat që kan pas me u dhën edhe le të na tregon ku interesi publik, nëse nuk ka pas interes publik mirë po tërhiqet po nëse insiston prap që ka interes publik le të na e shpjegon neve cka u kan interesi publik po filloj me parcelën 1032 -2 apo objektin e vjetër të komunës së Drenasit. Ky objekt me ngulm ishte provuar që të jepet në shfrytëzim në fund të vitit 2022 për të siguruar vota që të kalon kët propozim kryetari kishte provuar cdo mënyrë jub shpesh na keni thënë se ju nderin e ktheni me nder edhe të keqen e ktheni me të keqe po ju lutem borgjet e fushatav dhe nderet personale ti ktheni me parat e juaja e jo me parë të qytetarëve të Drenasit. Si qytetare e këti vendi nuk mundem me kuptu se cili është interesi publik e ekonomik i komunës që ngasra ku ndodhet objekti i vjetër i komunës për ndërtim të lartë pra banesa dhe lokale afariste, ky objekt ku gjendet salla e vetme në qytetin ton është dhe duhet të mbetet objekt publik me gjitha insistimet që i kemi pas deri tash prap ka pas tendenc për me dhën po më vjen mirë që qoft von sot ka një reflektim për kët parcel, një parcel tjetër e cila edhe kjo u propozu për me u heq është parcela 703-30, parcel kjo të cilën e kemi shfrytëzu në prill të vitit 2022, po kur e kemi pa insistimin që doni me dhën për ndërtim të lart e kemi kuptu edhe më mirë mos përkrahjen e juv ndaj qytetarëve që kishin prona në at parcel, kuptohet nuk është lehtë me ia prish qefin dostave për ndërtim të banesave. Nuk e harrojm se si keni provuar të manipuloni me votime për kët shpronësim, kur votimi me vetëm 15 asambleist prezent në sall e kishi konsideruar të suksesshëm e kur pas vërejtjeve tona ishi detyruar ta përsëritni votimin për ta realizuar me sukses kët dëm të madh ndaj qytetarëve ju kishi sjerll një kolege nga pushimi i lehonis, në kët list është edhe parcela e çerdhes publike të cilën e keni mohu në Janar kur ka ardh propozimi për prona që bëhet fjasl për atë parcel, sot u pranu në njëfar forme që është fjala për at poarcel nga kolegu Milaim Hajdari. Ju lutem përgjigjuni cili është interësi publik me maru banesa të larta në kurriz të pronës publike sidomos qerdjes që është qerdhja e vetme publike e Drenasit? Ju kemi bërë thirrje publikisht e personalisht asambles së komunës son që të mos votojn për këto prona pasi që kështu e dëmtojn interesin publik e po i lëm pa zgjidhje gjeneratat që vin për investime publike. Përkshkak të këtyre parregullsive pavarësisht që u hjekën tri prona që ende nuk janë votua po u propozua që të hjeqen në vetvendosje nuk jemi që të votojm për 51 prona, pra nëse merret parasysh propozimi i PDK-së që të ipen për 99 vjet. Ne nuk jemi kundër dhënjës në shfrytëzim sa herë që ka interes e leverdi komuna por jemi kundër që të ipen për 99 vite, pra tju lër barr gjeneratave të që vin pas neve

Kryetari i komunës Ramiz Lladrovci- listën që e keni pas dje është lista që është sot në votim janë hjek dy parcela që teknikisht sekretaria i ka fut në material e që janë në Komoran dhe u shtu një parcel e cila nuk u kan në list, nuk ka parcel tjetër dhe janë dërgu edhe skicat. Po thoni që unë kom shpërdoru detyrën ma shumë e kam për qytetarët e mi, nuk keni lën metod pa përdor, mu ka ba kontrolli i gjithë pasuris time dhe i gjithë familjarve të mi për me mujt mem gjet diqka për krejt origjinën deri më sot, cka u kan dallimi veq 0.70 cent u dal më shume. Sepse unë tën jetën tem jom thirr edhe kom luftu për lirin e Kosovës dhe për zbatimin e ligjit dhe kërkoj me u zbatu ligji nga cdo njëri. Anëtar i kuvendit Milaim Hajdari e shpjegoi listën listën paraprake edhe si përcaktohen se cilat prona ka interes publiku me i dhën në shfrytëzim. Arsyja pse kemi dasht me dhën parcelën te komuna e vjetër është sepse është e vjetër një vend ku ka mbeturin, e kafsh të ndryshme e kthyme në komun, kemi pas interes me 56 ari pronë me i marr komuna 5600 metër² objekt për interes të qytetarit duke përfshi zyra për komunën, zyra për njësi tjera të komunës sic është objekti i QPS-së, duke përfshi edhe sallë moderne të kulturës, salla për biblioteka, salla për takime të ndryshme, salla për aktivitete të grupeve politike. Ky objekt as 40% nuk i plotëson kriteret e një objekti të komunës që duhet mi pas.

Egzona Terdevci- Unë asnjëher nuk jom marr as nuk mirrem me jetën tanë personale, mua si asambleiste e Kuvendit Komunal të Drenasit më intereson se qysh e kryen punën si kryetar i komunës për cka je i thirrur, jeta jote private qysh ti e ndërtu pasurin janë pergjisi tuat nuk janë pergjisi të miat nuk e di pse po e ban një shpjegim të pa nevojshëm. Nuk dhe kurfar arsyshmerie pse ke dasht mi dhan këto tri prona tepër të rendësishme për shfrytëzim për 99 vite, mua po më vjen mirë që ke reflektu nuk e di kah ju ka ardh presioni normal prej neve gjithsesi si asambleist dhe prej qytetarëve besoj janë kan tepër të pa kënaqyr e të indinjun për pronat që ke dasht me i dhën po mbetet të ardhmen me pa kah u ardh ky presion që në moment të fundit me i terheq tri prona.

Kryetari i komunës Ramiz Lladrovci- asnjëher nuk e ke pa që e kom qit shpallje të veqant në votim pronën te komuna e vjetër as pronën tek qerdhja publike e keni par vetëm list paraprake, në list paraprake kemi dhjetra prona mbi 600 hektar, por 99 prej tyre nuk i kemi dergu në mbledhje për me percaktu kriteret, komisionet dhe me i percaktu pronat e interesit se kush me konkuru.

Arbër Halilaj- nga partia Green- I nderuar Kryesues i Seancës, z. Krasniqi,
Të nderuara kolege dhe kolegë të Kuvendit,
I nderuar Kryetar Lladrovci, Nënkryetar Shala, drejtoresha e drejtor, media dhe mysafirë të pranishëm,
Të respektuar qytetarë të Drenasit,

Miratimi i Ligjit për dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës Komunale në vitin 2019, është konsideruar atëbotë si një hap i duhur drejt fuqizimit të komunave, meqë ky ligj e kthente pronën komunale në një potencial zhvillimi ekonomik lokal, punësimi, në mundësi për investime në interesin e përgjithshëm të publikut.

Ky Ligj i ka zhbllokuar komunat nga pamundësia për të zhvilluar procedura për krijimin e infrastrukturës së domosdoshme e bazike në interes të përgjithshëm të komunitetit, siç janë: shkollat, çerdhet, spitalet, palestrat sportive, shtëpitë e kulturës dhe rinisë etj.

Potenciali investiv që e mundësojnë pronat publike nëpër komuna, ashtu edhe në komunën tonë, si dhe perspektivën e zhvillimit dhe interesit publik, varet pastaj nga programi qeverisës dhe orientimi zhvillimor i kryetarit të komunës bashkë me ekzekutivin lokal. Janë disa shembuj të pronës publike të kthyer në potencial për investime si zona zhvillimore apo industriale, siç quhen, pra kemi p.sh.: Parkun Inovativ Gjerman në Prizren, Parkun Zhvillimor Amerikan në Gjakovë, Parkun tonë Industrial në Korroticë të Eperme etj.

Sot kemi para vetës një Propozim-vendim për listën e pronave për vitin 2024, që janë planifikuar të jipen në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite. Destinimi i planifikuar i tyre sipas Hartës Zonale Komunale është ndërtimi i lartë në Drenas, destinimi tregtar, komercial e ndërtimor në Komoran, dhe kryesisht bujqësor në zonat tjera rurale. Si është menduar apo planifikuar zhvillimi ekonomik i Drenasit, që trumbetohet aq shumë, përmes dhënies së këtyre pronave? Aq më tepër, cili është interesi i përgjithshëm i komunitetit tonë në këtë rast? S'ka asnjë sqarim të detajuar,

përveç një Arsjetimi të gjeneralizuar të propozim-vendimit ku thuhet se qëllimi është që përmes investimit në fusha të ndryshme të ekonomisë, të krijohen kushte për zhvillim të bizneseve, për investime vendore dhe të huaja, që ndikojnë në zhvillimin ekonomik. Sa për prona publike që gjenerojnë zhvillim ekonomik përmes aktiviteteve të bizneseve prodhuese, shërbyese, tregtare etj. e kemi shembullin e Parkut Industrial që e cekëm më lart, e të cilin do të mund ta zgjerohim dhe bizneset t'i kushtëzojmë me punësimin e punëtorëve që janë banorë të Drenasit, siç veprohet zakonisht. Dua t'iu përkujtoj se për arsye që i kam cekur atëbotë, nuk e kam votuar HZK që ndërlihet me pronat që po i diskutojmë sot.

Një gjë është e vërtetë tek arsyetimi i Propozim-vendimit që e kemi para vetes: përmes këtyre pronave, pa kurrfarë analize, synimi apo vizioni të gjenerimit të zhvillimit ekonomik, është e saktë ajo që shkruan se do të zhvillohen bizneset (investitori) meqë do të rrisin volumin e të hyrave të tyre, sidomos ato që investojnë në ndërtime të larta në Drenas. Por, cila është arsyeshmëria ekonomike e investimit në një sferë të tillë në Drenas, në mbi 24000 m² ndërtim të lartë? Mos është shtimi i numrit të banorëve apo familjeve në Drenas, e që nuk po kanë ofertë të mjaftueshme për ta zgjidhur çështjen e banimit?

Për njoftim të opinionit, të theksoj se ligjet dhe rregulloret me anë të të cilave rregullohen procedurat dhe menaxhimi i pronave të dhëna në shfrytëzim janë:

1. Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen lokale;
 2. Ligji nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës;
 3. Ligji Nr. 06/L-021 Për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike.
- dhe si akt nënligjor:
1. Rregullore (QRK) nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

Ligji Nr.06/L-092 qartë e përcakton se dhënia në shfrytëzim dhe këmbim afatgjatë e pronës komunale duhet të ketë për qëllim zhvillimin e qëndrueshëm lokal, duke përfshirë komponentën ekonomike, sociale, kulturore, të mbrojtjes së mjedisit, gjenerimit të punësimit dhe më e rëndësishmja interesin e përgjithshëm dhe benefitet e qytetarëve të Drenasit, që tek ky Propozim-Vendim as që janë analizuar dhe definuar veçmas për secilën pronë.

Pse gjithë ky kundërshtim opozitar për një proces që do të duhej të ishte pikë bashkëpunimi dhe debati konstruktiv rreth asaj se si të rritet vlera e pronës publike dhe shtimi i projekteve investive në komunë, në interes të komunitetit të gjërë? Kush është keqbërësi në këtë rast, fjalë kjo e bastarduar, meqë Kryetari e ka përgjegjësinë kryesore qoftë për veprime keqbërjeje, keqqeverisje, qeverisje të mirë, bashkëpunim pozitiv-opozitiv, ose edhe përpjekjet për të shkatërruar opozitën, sepse është lideri i të gjithëve – i pari i komunës.

Ekzekutivi komunal ka dështuar tek llogaridhënia në raport me Kuvendin Komunal si autoritetin kryesor për menaxhimin e pronës komunale, sa i përket raportimit të rregullt sipas ligjit rreth kontratave ekzistuese të pronave komunale në shfrytëzim ose me qëra, përmbushjes së kriterëve investive dhe kushteve tjera në ato kontrata, aspektit financiar të tyre dmth. inkasimit të të hyrave komunale nga këto prona etj. Ne gjatë kësaj periudhe tri vjeçare nuk kemi pranuar në asamble raporte të rregullta dhe nuk është krijuar një sistem efikas i monitorimit të realizimit të

kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme deri tani.

A janë realizuar investimet e përcaktuara me kontratat aktive për pronat që janë dhënë në shfrytëzim? A ka kontrata, sa dhe cilat janë ato që janë ndërprerë apo nuk janë vazhduar për mosrespektim të kriterëve? A kemi raste kur shfrytëzuesit/qiramarrësit e pronës komunale kanë bartur të drejtën e shfrytëzimit tek palët e treta, pa miratim nga komuna? A janë prezentuar para Kuvendit në këtë legjislaturë të dhëna të sakta nga kartelat financiare të kontratave të qërasë, ku do të shihej arkëtimi ose jo i qërasë, vlera e borxhit të papaguar? Cilat janë kontratat e skaduara për pronën e paluajtshme të komunës, gjendja aktuale e pronave, kthimi i tyre tek komuna si dhe propozimet për destinimin e saj në të ardhmen?

Kjo do të duhej të ishte procedurë e brendshme për raportimin e rregullt të informacionit të nevojshëm për statusin e kontratave aktive/të skaduara nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik me afate dhe përgjegjësi, sipas paragrafit 2, nenit 22 të Ligji nr. 06/L-092, që do t'i prezentohej Kuvendit Komunal çdo 6 muaj gjatë gjithë punës së kësaj legjislature.

Prandaj, duhet thënë qartë se pretendimet që opozita në Drenas e ka synim pengimin e zhvillimit ekonomik të Drenasit janë supozime miope dhe për konsum elektoral, që opinionin e kupton dhe nuk i merr serioze, sepse jemi komunë e vogël dhe njihemi mirë. Përkundrazi:

- raportet e bizneseve të caktuara me politikën dhe ekspozimi i tyre sidomos nëpër fushata elektorale,
- fakti që zbatimi i procedurave ligjore dhe rregulloreve në fuqi nuk do të thotë që eliminohet apriori mundësia e konfliktit të interesit dhe e aferave korruptive....!
- mënyra e ashpër dhe vullneti në luftimin e opozitës si siguresë e demokracisë lokale,
- fluturimi nga subjekti në subjekt i asamblistëve jashtë arsyeve programore ose mospajtimeve partiake, duke e anashkaluar pozicionin që ua ka përcaktuar votuesi;
- lëshimet e lartcekura në sistemin e kontrollit dhe raportimit të kontratave të pronave publike etj.

Dëshmojnë për një jonormalitet të theksuar që e ka përcjellë punën e kësaj legjislature dhe raportet e krijuara brenda saj, nga e cila tani kërkohet një vendim lidhur me listën e pronave publike. Duke pasë parasysh këto elemente që i cekam më sipër, si dhe insistimin e mjaft qytetarëve, intelektualëve dhe ekspertëve të shquar të Drenasit me të cilët bashkëbisedoj e komunikoj që pronat të mos jepen kësisoji në shfrytëzim, unë jam edhe më i bindur që të votoj kundër këtij Propozim-vendimi.

Në aspektin njerëzor dhe si kolegë, e respektoj secilin nga ju të pranishëm në sallë, dhe natyrisht askujt nuk i bëj thirrje që bindjet tuaja për tematikën e diskutuar të përputhen me të miat. Secili e ka mënyrën e vet të argumentimit, arsyetimin dhe qëndrimin politik. Këtë deklaram e pata obligim moral më shumë për qytetarët që mund të na dëgjojnë, përditshmërinë dhe jetën e të cilëve e prekin vendimet tona, e të cilët na kanë dhënë përgjegjësinë t'i përfaqësojmë këtu. Vetëm ata dhe askush tjetër na vlerësojnë se si dhe çfarë kemi vepruar brenda kësaj legjislature. Unë ndihem i lirë të shpreh mendimin tim dhe të votoj ashtu siç mendoj se duhet në këtë rast, pa pasur asnjë obligim ndaj askujt. Për këtë arsye, e njoftoj Kryesuesen që për efikasitet sa i përket kohës, nuk do të kërkoj të drejtën e replikës edhe po mu përmend emri, edhe po s'i pëlqeu dikujt deklarami im, meqë unë e thashë atë që pata.

FALEMINDERIT për vëmendjen !

Beqir Kiqina nga AAK- sa i përket qëndrimit të AAK-së është bërë publik edhe më herët gjatë katërvjeçarit të kaluar kam qenë opozitë e këtij kuvendi komunal e vazhdoj të jem, e kam kundërshtuar dhe vazhdoj ta kundërshtoj Kryetarin Lladrovci me atë të gjitha pikat ku mendoj që nuk i ka shtjelluar mirë për interesin publik të Drenasit. Edhe mandatin e kaluar e kemi kundërshtuar për arsye se Drenasi nuk ka njoftë zhvillim ekonomik dhe nuk iu janë lejuar afaristëve, biznesmenëve për me investuar në Komunën e Drenasit dhe Aleanca së bashku me disa Partitë opozitare kujtojmë vitin 2017 kur e kemi kundërshtuar pse po na ikin investitorët prej Drenasit po shkojnë në komuna tjera. Ne si parti e AAK-së kemi mbajtur takime edhe me nivelin qendror edhe lokal dhe jemi të kordinuar që mos me përkrah kryetarin Lladrovci për zhvillimin e Komunës së Drenasit në ato pika ku ne mendojmë që është interes për komunën tonë.

Mehedin Salihu- pika e dhënës së pronave është një pikë e cila e ka fërkuar më së shumti pozitën dhe opozitën. Reflektimi i pozitës më përleu shumë po më duket pak i vonuar, dy minuta para hapjes së mbledhjes nuk bëhen këto ndryshime. Po më shqetëson fakti pse me kaq ngulmë të jepen 56 parcela kur kemi mundësi pjesë pjesë me i shqyrtuar më mirë edhe me i jep më ngadalë edhe ne i analizojmë më shumë edhe mbledhjet janë të vazhdueshme kemi mundësi, unë propozoj të gjithë të reflektojmë së pari opozita të reflekton që mbledhjen e ardhshme ta sjell këtë pikë prapë me ndryshime të shkrimeve jo vetëm të deklaronë.

Kryetari i komunës Ramiz Lladrovci- u kërkua nga lista paraprake që të tërhiqen prona me nr.18 parcela 743/30 R8510 në Glogoc, parcela tek komuna e vjetër nr.19 1032-2 5661 në Drenas banim i lartë dhe parcela 21 tek qerdhja parcela 768 -1 që është 1970 Glogoc pra këto tri parcela i ka kërkuar grupi parlamentar i PDK-së dhe unë i tërheqja dhe kërkoj që lista me parcela tjera të votohet unanimisht. Pse të votohen këto parcela për qytetarët e Drenasit, parcela prej rrethit rrugës regjionale tek varrezat Drenasit që e kufizon rrugën regjionale me hekurudhën dhe me lumin vermicë ka qenë një gropë septike e të gjitha ujrat e zeza të Drenasit sot është një objekt një pasqyrë, një pamje e jashtëzakonshme dhe një punsim i jashtëzakonshëm i një numri të madh. Poashtu prona në Arllat një pronë që dikur ka qenë një kosh me misër e cila sot është një qendër biznesi, një qendër ku komuna fiton

Hamit Haxhiu- sikur edhe më herët jam kundër këtyre pikave që të votohen domethënë për këto tri pika që ka deklaruar grupi parlamentar i PDK-së, në qoftë se editohet lista me këto tri prona që të largohen prej rastit unë jam pro listës që të kalojë.

Kryesuesi i mbledhjes Gani Krasniqi hodhi në votim propozimin për heqjen e tri parcelave tek pikë e tretë, prezent gjatë votimit ishin 30 anëtarë dhe votuan me: 28 vota (**Për**), kundër nuk pati 1 abstenim dhe një nuk ka votuar fare.

Pasi që nuk pati diskutime tjera Kryesuesi i mbledhjes Gani Krasniqi hodhi në votim pikën e tretë të rendit të ditës 3. **Propozim vendim për miratimin paraprak të Vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës së Glogocit për shfrytëzim afatgjatë**

personave fizik/juridik (për 99 vjet), prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar dhe votuan me: 17. vota (Për), 12 kundër dhe 1 abstenim.

Kryesuesi i mbledhjes, Gani Krasniqi- hapi diskutimin për pikën e katër të rendit të ditës: **4. Draft strategjia për Zhvillimin dhe fuqizimin e Rinisë në Komunën e Drenasit 2024-2029.**

Pasi që nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime Kryesuesi i mbledhjes Gani Krasniqi hodhi në votim pikën e katër të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 18 anëtar dhe votuan me: 14 vota (Për), kundër nuk ka dhe 2 abstenim.

Kryesuesi i mbledhjes, Gani Krasniqi- hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: **5. Raporti i punës Janar-Qershor 2024 i Kryetarit dhe qeverisjes lokale.**

Pasi nuk pati diskutime Raporti kaloj në Kuvend

Kryesuesi i mbledhjes, Gani Krasniqi- hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: **6. Raporti financiar Janar-Qershor 2024.**

Pasi nuk pati diskutime Raporti kaloj në Kuvend

Kryesuesi i mbledhjes, Gani Krasniqi- hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës: **7. Diskutim i Raportit i Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) për vitin 2023.**

Pasi nuk pati diskutime Raporti kaloj në Kuvend

Kryesuesi i mbledhjes, Gani Krasniqi- hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës: **8. Diskutim i Planit të Veprimit për Implementimin e Rekomandimeve të ZKA-së**

Pasi nuk pati diskutime Raporti kaloj në Kuvend

Kryesuesi i mbledhjes, Gani Krasniqi- hapi diskutimin për pikën e nëntë të rendit të ditës: **9. Raporti i punës së KKSB-së Janar-Qershor.**

Pasi nuk pati diskutime Raporti kaloj në Kuvend

Kryesuesi i mbledhjes, Gani Krasniqi- hapi diskutimin për pikën e dhjetë të rendit të ditës: **10. Propozim vendim i Buxhetit të komunës për vitet 2025 dhe parashikimi i buxhetit për vitin 2026-2027.**

Kryetari i komunës Ramiz Lladrovci - anëtarët nga VV dhe nga DD kan kërku kët pik me dërgu javën tjetër në kuvend mirpo unë theksova se është pik brenda mbledhjes së jashtzakonshme dhe i bëra lutje se cka po dojn me ndryshu në buxhet jam i gatshëm me ju ftu si grup parlamentar me ba ndryshime nëse na lejohen ne pik edhe në kod, dhe ju lutem propozoni

qka po doni me ndryshu që na ta ndryshojm sepse të gjitha këto projekte janë për të mirën e qytetarëve të Drenasit e jo vetëm për të mirën e një grupi politik

Egzona Tërdevci- Kryetari e përmendi që ishte kërkesa e jona me shty piken për diskutimin për buxhet pasi është pika më e rëndësishme e vitit pora miratimi i buxhetit 2025 është një pikë e cila kërkon trajtim të veçantë dhe nuk meriton të futet në kesi soj me një seancë të jashtëzakonshme, në situatën kur nuk ka mirëkuptim për me shty këtë pikë me tërheq me e sjell në diskutim herën tjetër sepse është edhe pak e pa logjishme që buxheti me kalu pa qen në diskutim tek Komiteti për Politik dhe Financa. A ka mirëkuptim për me e shty?

Kryetari i komunës Ramiz Lladrovci - Me ken me pas mirëkuptim ju kisha kërku asamblëistave të cilët po rrin këtu për me marr vendime për buxhetin për vitin 2025 dhe projeksionet për vitin 2026-2027. Shkaku që nuk ka qen në KPF nuk është faj i asnjërit nga këta asamblëist që e kanë propozuar për me qit në rend të ditës sepse është faj i 16 asamblëistëve që e shkarkuan kryesuesin e kuvendit dhe e kanë paralizuar kuvendin, nuk ka mirëkuptim dhe unë mendoj që grupi parlamentar i PDK-së vazhdon me votimin e pikës së rendit të ditës pavarësisht qysh ju kërkon

Azmine Bujupi Gjoka- në emër të DD-së konsiderojm se pika e dhjetë për buxhetin e vitit 2025 dhe parashikimi i buxhetit të vitit 2026-2027 të shqyrtohet në një seancë tjetër të rregullt sepse është pikë shumë e rëndësishme e vitit dhe kështu që e don kohë dhe analizë, kisha pas dëshirë me diskutu në KPF pasi që nesër mbahet

Egzona Tërdevci- ne si Vetvendosje kësaj radhe nuk kemi dërguar propozime me shkrim po i ripërsëritim kërkesat tona nga viti i kaluar si mbështetjen për lehonat me 100 euro e falënderoj Kuvendin Komunal që e ka mbështetur me votë vitin e kaluar si dhe mbështetjen për fëmijët për financimin të Çerdheve familjet me të ardhura të ulta të mbështeten për financim të të çerdhës pra ky projekt është miratuar në vitin e kaluar po asnjëherë nuk është zbatuar dhe asnjëherë nuk ka pas një vendim, përderisa nuk ka thirrje nuk mundën me aplikuar askush. Ne e ripërsëritim kërkesën e vitit të kaluar që të ofrohet mbështetje për fëmijët e familjeve të cilët kanë të ardhura të ulta. Vazhdon me qen problem grumbullimi i projekteve kapitale është e pa qart për cilat projekte bëhet fjalë kur janë të grumbulluara në formën në cilën na u kanë paraqitur, ka ulje të shpenzimeve të investimit kapitale në infrastrukturë rrugore nga viti 2023, ka ulje të shpenzimeve të investimit kapitale për shëndetësi poashtu e shohim disa projekte kanë ulje të draftit që e kemi pranuar në Qershor, shumë projekte të arsimit gjithënjë gjasht prej tyre janë me zero vlerë. Cila është arsyeja pse janë me zero vlerë? a është qëllimi vetëm me i shtu në pip me mundësinë me u financuar ma von a pse kanë mbetur gjatë projekte të Drejtorisë e Arsimit me zero investim. Ka ulje të shumica e projekteve të infrastrukturës publike nga drafti që e kemi pranuar në Qershor pse ka ndodhur kjo sepse kur i lexon diskutimet publike me pak pjesëmarrës, ka shumë kërkesa nuk po e kuptoj në vend me u ngrit shumat nga drafti i qershorit të shumica e projekteve ka ulje poashtu po më vjen mirë që më në fund keni reflektuar për rrugën dhe trotuarin në Arllat, Negroc dhe Vuqak pasi që vazhdimisht kemi marr anketa nga qytetarët e vlerësoj që janë rreth 200000 euro për këtë projekt si dhe po përfolet që Drenasi nuk po mbështetet nga niveli qendror po nëse hyni dhe i shikoni ligjet e buxheteve ndër vite e vëreni që asnjëherë nuk ka pasur më shumë financim nga granti qendror. Financimi nga niveli qendror për Drenasin në vitin 2019 ka qenë 13,701814 e prandaj është e pa drejt kur thuhet se nuk po financohet Drenasi kur e dimë që edhe projektet për

të cilat ne po ndajm parcela nuk po dorzohen deri në fund siq duhet me dokumentacion, është rasti i dy Çerdheve, rasti i banimit social sic është për ta ndihmu në këtë propagandën e juj për sabotim të Drenasit nga niveli qendror

Kryetari i komunës Ramiz Lladrovci- kur folim për grant qeveritar, grandit qeveritar e ka një formul. Për dinin tande asnjë cent qeveria këto vite nuk ia ka nda Drenasit, granti është i detyruar niveli qendror me nda për numër të banorve dhe për territor të komunës. Pronat i kemi nda me kohë edhe këto nuk ishten e kemi pas plan zhvillimor edhe e kan qit thysa sepse kur dojn i qesin edhe ne i kemi kry dhe i kemi dergu, pra këto nuk shiuten se jan demode kemi vullnet sepse nuk jemi të krisun mos me ia dhën mundësin nivelit qendror me ndërtu çerdhe për fëmijët e komunës son.I ftoj të gjithë anëtarët e kuvendit ta votojn buxhetin që ti përfundojm procedurat në futjen në pip sepse ka shumë probleme edhe për ata e kemi shtu edhe një pik ku e kan pllato të shkollave ku e kan qu gabimisht në pip ne duhet me ndryshu

Egzona Tërdevci- z. Lladrovci e di formulën që ndahet, po nëse nuk kish përformu mirë qeveria me siguru më shumë të ardhura pavarësisht numrit të banorve prap e kishe marr shumë përafërsisht njejt sa e ke marr në vitin 2019. Nuk më dhe përgjigje për gjasht projektet e Drejtoris së arsimit të investimeve kapitale që kan mbet me vler zero e as nuk mora përgjigje për uljen e projekteve që është bër edhe a mundem me marr konfirmim prej juve, prej asaj cka that se dokumentacionet për dy çerdhet që kemi nda parcelat janë kryer se në komunikimin e fundit me shkrim që e kom pas me z.Gjoka ka qen idea se ende nuk i kem përfundu dokumentacionet përkatse

Kryetari i komunës Ramiz Lladrovci- sa i përket buxhetit i kemi përputh me centa sepse ashtu na duhet me përputh me projekt qarkoren që na dërgojn qeveria

Muhamet Gjoka- sa i përket ndërtimit të dy çerdheve ne veq e kemi pas një komunikim ju jeni në din se ndarja e liokacionit vec është bër, është miratu nga ky kuvend dhe ne kemi kemi kalu në hapin tjetër, në faza tjera për hartimin e laboratit të cilin e kemi shpall dy her dhe nuk ka pas opertus dhe u dassht që të vazhdojm me procedura dotëthot para se të kërkojm prej ministris ti paisim me leje na duhet që të hartohet elaborati për këto dy lokacione i cili tash vec është në fazën e nënshkrimit të kontratës që kërkohet si parakusht për vazhdimin e procedurave. Vlersimi është bër është në procedurën e prokurimit brenda jave besoj që vazhdohet tutje

Pasi që nuk pati diskutime tjera Kryesuesi i mbledhjes Gani Krasniqi hodhi në votim pikën e dhjetë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 25 anëtar dhe votuan me: 20 vota (**Për**), kundër nuk ka dhe 1 abstenim.

Kryesuesi i mbledhjes, Gani Krasniqi- hapi diskutimin për pikën e njëmbëdhjet të rendit të ditës: **11. Raporti i performancës komunale për vitin 2023 për komunën e Glllogocit.**

Pasi nuk pati diskutime Raporti kaloj në Kuvend

Kryesuesi i mbledhjes, Gani Krasniqi- hapi diskutimin për pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës: 12. **Propozim vendim për transfer/harmonizim në kategorinë e pagave.**

Pasi që nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime Kryesuesi i mbledhjes Gani Krasniqi hodhi në votim pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 23 anëtar dhe votuan me: 19 vota (**Për**), kundër nuk ka, abstenim nuk ka

Kryesuesi i mbledhjes, Gani Krasniqi- hapi diskutimin për pikën e trembëdhjetë të rendit të ditës: 13. **Propozim vendim për ndryshimin e emrit të projekteve.**

Kryetari i komunës Ramiz Lladrovci- ky është ajo që tham se dy projekte pllatova rrethojave të shkollave kan qenë në emër të dy shkollave tjera gabimisht kan hy në pip dhe ne nuk mundëmi me i zhvillu procedurat pa e ndrru. Ju ftoj me votu këtë pikë

Pasi që nuk pati diskutime tjera Kryesuesi i mbledhjes Gani Krasniqi hodhi në votim pikën e trembëdhjetë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 23 anëtar dhe votuan me: 18 vota (**Për**), kundër nuk ka, abstenim nuk ka.

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi e konsideroj të mbyllur seancën, seanca përfundoj rreth orës 14:00 min.

Me gjerësisht, mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Drenasit të datës 19.09.2024 mund të ndiqni në ueb faqen zyrtare të komunës, rrjetin social të Fecebook-ut dhe në kanalin YouTube.

Procesmbajtëse:

Indira Olluri Thaçi



Kryesuesi i mbledhjes

Gani Krasniqi



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/64-51122 dt. 18/10/2024

PROCESVERBALI

I mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: **30.09.2024** e cila filloi në orën 10:00.

Mbledhjen e kryesoi anëtarë me i vjetër i Kuvendit Komunal Gani Krasniqi Dhe i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 30 anëtarë: Labinot Halilaj (PDK), Bekim Lestrani (PDK), Arigon Sinani (PDK), Zeqir Hasi (PDK), Laurita Muhadri Bujupi (PDK), Hamit Kastrati (PDK), Blerina Gashi (PDK), Gani Krasniqi (PDK), Fatmir Baliu (PDK), Qendrim Mulaj (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Blerina Gashi (PDK), Valentina Leku (PDK), Manushaqe Mulaku (PDK), Mirlinda Dvorani (PDK) Sali Dvorani (DD), Mergim Pirraku (DD), Mehedin Salihu (DD), Hamit Haxhiu (DD), Jahir Hajdari (DD), Azemine Bujupi-Gjoka (DD), Marigona Bazaj (DD), Florentina Elezi-Veliu (VV), Filloreta Bujupi (VV), Drin Halilaj (VV), Egzona Terrdevci (VV), Muhamet Kurtaj (VV), Arbër Halilaj (GREEN), Beqir Kiqina (AAK), Egzon Qorri (LDK). Sali Dvorani (DD). *Mungoi Labinot Halilaj*.

Të pranishëm ishin edhe Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, Nënkyetari Arben Shala, Drejtor të Drejtorive komunale, përfaqësues të KFOR-it, përfaqësues të OSBE-s zyra e informimit, .

Mbledhja filloi punimet me këtë rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i Kuvendit Komunal Drenas të dt. **30.5.2024**
2. Procesverbal i mbledhjes së jashtëzakonshme e dt. **06.06.2024**.
3. Procesverbal i mbledhjes së jashtëzakonshme e dt. **06.09.2024**.
4. Procesverbal i mbledhjes së jashtëzakonshme e dt. **13.9.2024**
5. Propozim vendim për Financimin e projektit "Handikos"
6. Propozim vendim për aprovimin e Planit të punës për Ekipin Komunal për të drejtat e Fëmijës, Drenas (2024-2027)
7. Propozim Vendim për ndryshimin e emrit të NPL "Ekologjia" Sh.A. në EKO-Drenasi Sh.A
8. Propozim Vendim për transfer të mjeteve financiare subvencione dhe transfere.
9. Propozim Vendim për transfer të mjeteve financiare nga Rezerva në kategorinë Ekonomike Investime Kapitale.
10. Propozim Vendim Për faljen e taksave komunale për veprimtaritë e biznesit të komunës së Drenasit për periudhën 01.01.2000 deri 31.12.2019

11. Propozim Vendim për rritjen e të hyrave vetanake
12. Të ndryshme.

Anëtari me i vjetër i Kuvendit Komunal Gani Krasniqi fjalën i ja jep kryetarit të komunës për dy pika shtesë .

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci-ju përshëndes unë i kam dy pika shtese që janë shumë më rëndësi për me hin në këtë mbledhje. Propozim Vendim Për faljen e taksave komunale për veprimtaritë e biznesit të komunës së Drenasit për periudhën 01.01.2000 deri 31.12.2019 Propozim Vendim për rritjen e të hyrave vetanake.

Ne e kemi tejkaluar buxhetin dhe kemi nevojë për 6000 mije euro me i aloku sot në projektin e urës mbi lumin Drenica dhe mbi hekurudhë për me bërë rrugën nga Kroni i mbretit në drejtim të Feronikelit dhe kemi nevojë për ndriqim kështu që unë ju kisha propozuar, është vendim i juaji a e aprovon i jo sepse nuk kemi kohë është tetori derisa të kthehet ligjshmëria shkojnë pesëmbëdhjetë ditë faleminderit.

Anëtari me i vjetër i Kuvendit Komunal Gani Krasniqi- a është dikush për diskutim për këto pika shtesë?

Egzona Tërdevci-i nderuar kryesues për korrektësi nuk janë shtuar dy pika, nga data kur është thirrë seanca janë shtuar pesë prej pikës shtatë deri tek pika dymbëdhjetë është bërë praktikë shumë e keqe që me u trajtuar Kuvendi komunal si shumë i pa rëndësishëm d.m.th bënë me i sjell propozim në momentet të fundit edhe kuvendi komunal është vetëm makineri e votimit asgjë më shumë ,unë nuk ka asgjë kundër këtyre dy propozimeve që erdhën sot por është bërë praktikë e keqe kjo ,sa i përket propozimit për faljen e taksave komunale ky edhe ashtu ka qenë propozim i lëvizjes vetëvendosje në mandatet e kaluara nga koleget tonë asamblist por nuk mundemi me fal borgje pa e ditur cilave biznese pa e pasur një liste ,dokumente qe e përcjellin këtë propozim, dhe a po e mendoni pa drejtësinë që ju keni bërë bizneseve që kanë paguar , a po e sheh sa e pa arsyeshme është taksa komunale që e keni vendos për biznese në Drenas në fakt për mos me të mbajt përgjegjës për pjesën kur ke ardh ti ,unë mendoj që këto duhet me u trajtuar me një seancë tjetër sepse është e pa arsyeshme kjo praktik e keqe që po ndërtohet faleminderit.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci-propozimi për faljen e taksave ka ardh prej qeveris i kundërligjshëm dhe unë i kom detyruara ata në kuvend të Kosovës për me pas të drejt ne me fal taksen dhe e kemi vendos jemi të parët që e kemi fal, nuk ka rëndësi propozimi prej kujt vjen pikat që i përmende është e vërtete që janë jashtë takimit të KPF-së sepse nuk keni mbajt mbledhje të rregullt të kuvendit prej muajit prill, maj dhe kemi nevojë me urgjencë me shqyrtuar pikat p.sh pika për emërimin e kompani së mbeturinave është ardh nga vlerësimi i ligjshmërisë ne e kemi detyrim me e ndërru emrin sepse ekziston një emër i përafërt i tillë ,vendimi për faljen e borgjeve e keni shumë dhe vitet ,nuk i bëjmë favore as nuk e penalizojmë askënd për këto.

Anëtari me i vjetër i Kuvendit Komunal Gani Krasniqi faleminderit kryetar për sqarimin , dhe hedhe në votim rendin e ditës me ndryshime me dy pikat shtesë

Për votuan 24 , Abstenim 3 , Kundër 0

Anëtari me i vjetër i Kuvendit Komunal Gani Krasniqi hodhi në votim pikën :

1.Procesverbali i mbledhjes së rregullt i Kuvendit Komunal Drenas të dt. 30.5.2024.

Egzona Terdevci : kjo seancë nuk është mbajt dhe nuk është votuar rendi i ditës prandaj nuk me duket e arsyeshme me miratu një proces verbal për një seancë e cila nuk është konsumu.

Për votuan 28 , Abstenim 0 , Kundër 1

Anëtari me i vjetër i Kuvendit Komunal Gani Krasniqi hodhi në votim pikat: 2.Procesverbal i mbledhjes së jashtëzakonshme e dt. 06.06.2024. 3.Procesverbal i mbledhjes së jashtëzakonshme e dt. 06.09.2024.4.Procesverbal i mbledhjes së jashtëzakonshme e dt. 13.9.2024 , dhe të tri pikat kalojnë në mënyrë unanime .

Anëtari me i vjetër i Kuvendit Komunal Gani Krasniqi hapi për diskutim 5.Propozim vendim për Financimin e projektit “Handikos

Egzona Terdevci : Ne si VV e mbështesim këtë ndarje ani pse është shumë e vogël por e kemi pa që aq ka qenë limiti i thirrjes po e ftojë publikisht zotëri Lladrovci që të konsideroj që të ju bëjë zgjidhje për objekt” Handikosit” se në kushte të vështira operojnë edhe dimë që komuna e ka një objekt të lirë ,kështu që mundet me ju bërë zgjidhje.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: me pas bërë ne objektin e ri të komunës ka qenë i planifikuar objekti edhe për Handikosin ,por do ta bëj aty ku ju keni kërkuar më shfrytëzuar në dobi të qytetarëve.

Anëtari me i vjetër i Kuvendit Komunal Gani Krasniqi hodhi në votim pikën 5.Propozim vendim për Financimin e projektit “Handikos

Për votuan 29 , Abstenim 0 , Kundër 0

Anëtari me i vjetër i Kuvendit Komunal Gani Krasniqi hapi për diskutim : 6 Propozim vendim për aprovimin e Planit të punës për Ekipin Komunal për të drejtat e Fëmijës, Drenas (2024-2027)

Egzona Terdevci : neve na u është përcjell vetëm propozim vendimi për komision edhe për me miratu këtë plan por plani nuk na është përcjell , i cili është në web faqe të komunës por plani i veprimt pra shifrat buxheti për realizimin e këtij plani nuk janë askund në web faqe të komunës edhe nuk na kanë përcjell ,unë kam me votu për shkakë se përfaqesuesja jonë thotë që gjithçka është në rregull me atë komision po nuk është në rregull kjo praktik mos me i sjell dokumentet e kompletuara në kuvend rregullojeni këtë send .

Anëtari me i vjetër i Kuvendit Komunal Gani Krasniqi hodhi në votim pikën 6. Propozim vendim për aprovimin e Planit të punës për Ekipin Komunal për të drejtat e Fëmijës, Drenas (2024-2027).

Për votuan 29 , Abstenim 0 , Kundër 0

Anëtari me i vjetër i Kuvendit Komunal Gani Krasniqi hapi për diskutim pikën 7.Propozim Vendim për ndryshimin e emrit të NPL “Ekologjia” Sh.A. në EKO-Drenasi Sh.

Diskutime nuk pati edhe pika e shtatë e rendit të ditës kalon në mënyrë unanime.

Anëtari me i vjetër i Kuvendit Komunal Gani Krasniqi hodhi në votim pikën 8. Propozim Vendim për transfer të mjeteve financiare subvencione dhe transfere.

Pasi diskutime nuk pati hodhi në votim pikën e tetë të rendit të ditës .

Për votuan 28 , Abstenim 1 , Kundër 0

Anëtari me i vjetër i Kuvendit Komunal Gani Krasniqi hapi për diskutim pikën: 9. Propozim Vendim për transfer të mjeteve financiare nga Rezerva në kategorinë Ekonomike Investime Kapitale.

Egzon Terdevci: E kam në pyetje për këtë në arsyetimin që ka dërguar komuna thuhet që transferi i mjeteve financiare nga rezerva bëhet me qëllim të shtyrjes së obligimeve kontraktuale për projektin numër 53687 i cili është ndikuar negativisht nga vendimet e formës së prerë të autoriteteve përmbarimore për pagesat obligimet e dalura nga kontrata kolektive të arsimit dhe shëndetësisë a mundeni me e sqaruar se a i ka marre përmbarimi paret e dalura prej projektit se pse qysh e dijm paraprakisht bëhet zotimi i mjeteve financiare për se cilin projekt nuk po e kuptoj së qysh munde me i marrë mjetet që janë të zotuara për një projekt tjetër.

Drejtori i Arsimit Muhamet Gjoka –përshëndetje për të gjithë si sqarim shitesë në vitin e kaluar ky projekt ka qenë projekt dy vjeçar furnizim për kabinetet e shkollave në komunën e Drenasit d.m.th pjesa e parë është përfunduar në vitin e kaluar ndërsa buxheti që ka qenë i paraparë për këtë vit për të cilin ende nuk jemi furnizuar është marrë nga përmbaruesi për obligimet e kontratës kolektive dhe kemi kërkuar që të bartën këto mjete nga rezerva në këtë projekt në mënyrë që të realizohet ky projekt.

Anëtari me i vjetër i Kuvendit Komunal Gani Krasniqi hodhi në votim pikën: 9. Propozim Vendim për transfer të mjeteve financiare nga Rezerva në kategorinë Ekonomike Investime Kapitale.

Për votuan 25 , Abstenim 4 , Kundër 0

Anëtari me i vjetër i Kuvendit Komunal Gani Krasniqi hapi për diskutim pikën 10. Propozim Vendim Për faljen e taksave komunale për veprimtaritë e biznesit të komunës së Drenasit për periudhën 01.01.2000 deri 31.12.2019

Beqir Kiqina – kisha deshtë me ia bërë një pyetje konkrete drejtorisë për zhvillim ekonomik në këtë listë për faljen e taksave a futen edhe bizneset individuale p.sh: kemi rastet e bizneseve individuale të cilat nuk janë trajtuar me rregull edhe me kode të veçanta si p.sh ka instruktor të caktuar të cilët kanë biznese individuale dhe për ato biznese ata duhet me pagur në baze të qarkullimit, ka individ të cilët kanë biznes individual dhe kontraktohen nga gjykata p.sh për me dhanë ekspertiza për trafikun rrugorë për ndeshjet të cilat ndodhin, ndërsa trajtohen me kod të kontrollimit teknik nuk e kanë një kod të veçantë që duhet me pas edhe kanë të ngarkuar edhe pse prej vitit 2019 deri me tani kanë zero të hyra ka raste ku bizneset e ngarkume prej 1300 euro edhe pse të hyrat kanë qenë zero a ka mundësi me ditë a trajtohen edhe këto biznese për faljen e borgjeve a po jo?

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci-të gjitha bizneset edhe ato individuale çdo biznes në komunën tonë që ka qenë ndonjë herë i regjistruar d.m.th prej 01.01.2000 deri 31.12.2019 i falet taksa komunal.

Mehdin Salihu –përshëndetje për të gjithë së pari deshta të them rreth kësaj pikë se siç e ceki edhe Egzona kërkesë e opozitës ka qenë falja e borgjeve për të gjitha bizneset , pozita nuk ka përkrahur hiq në këtë drejtim , edhe vërejtja e ime ka qenë se mbi tri vite veprimtari nuk keni të drejtë me ligj

me i kërkuar borgjet paraprake është ligji kryetar e shikon që po e kthen përmbaruesi megjithatë unë e përkrahi këtë pikë po i kam disa pyetje konkret :

1. Çka ndodhe me lëndët që një numër i madh janë të përmbaruesi?

2. Çka ndodhë me ato biznese që i kanë kryer obligimet për këtë periudhë kohorë prej vitit 2000 ?

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci – çdo biznes që ka qenë në proces para tri vite ai shkon deri në fund procesi i tij ndërsa tri vitet e fundit në çoftë se ne nuk kemi kërkuar me ja marrë taksen ose mjetet atëherë ne e humbin të drejtën me marr .

Mehdin Salihu-me ligj është që e kthen edhe përmbaruesi ja ka kthyer lëndën, çdo borgj apo obligimi që biznesit nuk ja ke paguar brenda tri viteve nuk ke të drejt edhe nuk mundesh me faturu , prej viti 2000 me faturua borgj atë biznes e mbysim ajo është dobësi e madhe nëse nuk e ka kërkuar inspektori edhe organet s'këm të drejt lexoje kthimin e përmbaruesit që i ka kthyer lëndët .

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci-ata taksa pagues që kanë paguar prej vitit 2000 janë të ndershëm se e kanë kryer obligimin ligjore qe kanë pas ndajë komunës dhe qytetarëve ,nuk ndodhë asgjë i falënderojmë , ndërsa këta që nuk e kanë paguar është faji i komunës që prej vitit 2000 nuk i kanë mbledhur borgjet ne sot po kërkojmë me i fal .

Egona Terdevci – e mbështesim por po kërkojë me e pas një listë me borgjet sa i ka pas secili biznes nëse nuk na e dërgoni kështu mundemi me e kërku edhe qasjen në dokumente publike po shpresoj në mirëkuptimin e juaj .

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- të gjithat janë në sistem edhe ju a dërgojnë linkun, është shumë normale për çdo njërin që ka pasur borgje edhe që ne po ja falim sot.

Arbër Halilaj-nuk dua ti shtojë diçka arsyetimit të propozimit jam për këtë, mirëpo kisha dashtë që ekzekutivi respektivisht drejtoria për zhvillim ekonomik dhe për buxhet dhe financa të analizojnë, a kishte mundur te shtohet një nen ku i lirojmë edhe bizneset që kanë qasje direkte ne shesh për shkak të humbjeve që kanë nga punimet që janë duke u bërë në shesh.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci-ne po flasim për një kohë të caktume nuk mund të shtim në tjetër ne mund të mbajmë tjetër mbledhje e propozojmë edhe shohim, por nuk kemi me lënë me borgje të kompanive ose institucioneve të ndryshme pa i inkasuar ose pa i dërguar me kohë të përmbaruesi.

Milaim Hajdari – lidhje me këtë pikë të rendit të ditës edhe unë e kisha ngritë çështjen që e potencoi Beqa është një kategori inspektor ose eksperte të komunikacionit do të thotë zakonisht ka shumë pak punë thirren shumë rrallë kur ka aksidente por megjithatë në kod janë bëjnë pjese në kodin e këtyre kompanive të kontrollimit teknik d.m.th është si e kontrollimit teknik ata edhe punën qe e banjë nuk është qe ja mbulojnë taksën por realisht është mirë me diskutu me drejtoreshën me tutje si është e mundur këtë kategori me nxjerr prej situate unë kam pasur raste edhe vetë kur e kemi miratu rregulloren për taksa tarifa kanë qenë disa ankesa por është e mirë nëse është e mundur më bërë diçka , është e pa rëndësishëm nga kush ka ardh e rëndësishme që po behët falja e taksave dhe një borgj që i takon të kaluarës është mirë me u bërë një prerje dhe tash e tutje e ke një pasqyrë të qartë faji i për borgje është 50-50 se edhe komuna ka për obligim me njoftuar tatim paguesi së e ki ketë borgje për derisa komuna ka heshtë taksa ka ecë aty është grumbullua e mira është qe këto po falen .

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- vlerësuesit në komunikacion kanë të drejt me e ndërru kodin në komunë ,shumën nuk e përcaktojmë ne sepse është e përcaktume në nivel qendror edhe në jemi të detyruar në bazë të kodit me vepruar, sa i përket borgjeve ose prerjeve nuk është që po i falim qytetarët tonë për borgjet për të cilat ju thatë që faji është 50-50 por çdo institucion çdo kompani qe

ka taksë edhe pa ja dërguar vendimin është i obliguar me pagu taksën e vet megjithëse ne duhet me ia dërgu por shpesh herë për shkak të pagesave të mëdha nga posta ne jemi detyrat vetëm me ja dërgu njoftimin ,dhe shpesh herë nuk e pranojnë njoftimin por tani qdo gjë është në sistem edhe nuk mundet me i ik askush shuma është fikse e të gjitha borgjeve është shuma prej 2 milion.

Mehdin Salihu- nuk e mora përgjigjejen se çka ndodhë me lëndët janë në përmbarrim?

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- për cilin vit e keni fjalën, çdo pagesë që ka pas më u bërë deri ne vitin 2000 31.12.2019 përfundon me vendimin pasi të marrim ligjshmërinë prej MAPL-së pra ata që janë në përmbarrim sigurisht përfundojnë ato që janë pas 2021 pastaj 2022,2023,2024 e kanë obligim me i paguar edhe nëse nuk i pagu e dërgojmë me kohë të përmbarruesi.

Anëtarë me i vjetër i Kuvendit Komunal Gani Krasniqi hodhi në votim pikën 10.Propozim Vendim Për faljen e taksave komunale për veprimtaritë e biznesit të komunës së Drenasit për periudhën 01.01.2000 deri 31.12.2019

Për votuan 30 , Abstenim 0 , Kundër 0

Anëtarë me i vjetër i Kuvendit Komunal Gani Krasniqi hapi për diskutim pikën, 11. Propozim Vendim për rritjen e të hyrave vetanake

Egona Terdevci- kam për diskutim të pjesa e ndarjes për rrugën tranzit Drenas –Kroni i mbretit kjo rrugë sa unë e di është pothuajse në përfundim qka ka me u bërë me këto 500 mijë euro.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- me zëvendësministrin e infrastrukturës kemi memorandum për shkake të shpëputjes të kontratës të ndërtimit e urës mbi lumin Drenica dhe mbi hekurudhë prandaj këto mjete janë për urën dhe nëse na nuk e ndërtojmë mbi 100 metra projektin neve na humbin 300 mijë euro grand i qeverisë dhe nuk i kemi nëse nuk i shfrytëzojmë , edhe i kemi 250 metra rrugë pa përfundime në Poklek te vjetër e cila e shkurton prej Kronit të Mbretit në drejtim të Drenasit dhe Skenderajt .

Anëtarë me i vjetër i Kuvendit Komunal Gani Krasniqi hodhi në votim pikën, 11. Propozim Vendim për rritjen e të hyrave vetanake

Për votuan 29 , Abstenim 0 , Kundër 0

Anëtarë me i vjetër i Kuvendit Komunal Gani Krasniqi hapi për diskutim pikën 12.Të ndryshme.

Egona Terdevci-i kam dy pyetje për drejtorin e infrastrukturës janë dy çështje të ndriçimit publik në Gillobar në rrugën Flamur Morina ku ka shtylla betoni ja kam dërgu imell drejtorit po nuk me është përgjigj ,dhe rruga Martiret e Elshani të dyja këto janë bërë kërkesa në dëgjimet buxhetore prej administratorit të fshatit edhe lagjeve të caktune .

Drejtori i infrastrukturës Endrit Gllareva – unë e kam pranuar emailin sot të konfirmoj d.m.th hapet oferta për ndriçim publik edhe brenda atij projektit kanë me qenë edhe to dy rrugë të cilat i keni cek edhe ju.

Valentina Leku –kam një pyetje për Drejtorin e infrastrukturës me qenë se këtu u diskutu për Komoranin edhe Arllatin a përfshihet edhe fshati Llapushnik pasi janë shtyllat e betonit .

Drejtori i infrastrukturës Endrit Gllareva- po Valentin sepse kontrata e ndriçimit publik i përfshin të gjitha fshatrat e Komunës së Drenasit d.m.th është kod gjithëpërfshirës .

Beqir Kiqina dëshiroj të ja bëj një pyetje drejtorisë për shërbime publikë a ka mundësi që drejtoria për shërbime publikë që të jetë në kontakt me ministrin e infrastrukturës dhe të marr masa tek dy shkollat e mesme respektivisht të Gjimanazi “Gjergj Kastrioti Skenderbeu” edhe shkolla Tenike “Fehmi Lladrovci” të rruga kryesore aty me marrë dhe me vendose gunga në rrugë apo pengesa për arsye se aksidente janë shumë evidente , viteve të fundit dhe ka shumë nxënës të cilët janë lënduar nga personat e pa ndërgjegjshëm të cilët vozitin pavarësisht shenjave të trafikut që janë ne e dimë që gjendja aty është alarmante, nuk është Komuna po a ka mundësi që komuna të bëjë më shumë në këtë aspekt dhe të ndërmarrin masa preventivë në bashkëpunim ministrin e infrastrukturës .

Nexhmedin Gruda –drejtoria e shërbimeve publike vazhdimisht për çdo javë ju përcjell zyrtare të cilat mund edhe ti forwardoj kërkojmë departamentit të rrugëve në kuadër të ministrisë se infrastrukturës që të behët rehabilitimi i gropave por edhe siguria me shenjat për sa lejon ligji.

Valentina Leku- kam një pyetje për Drejtorin e Arsimit Muhamet Gjoka kur ka me u bërë rishikimi i rregullores së shkollës edhe a ka mundësi që në këtë rregullore me u listu detyrat dhe përgjegjësit e mësuesve përgjegjës mbështetëse asistentëve masë disiplinore për nxënës që arrin një numër të madh të mungesave , po ashtu nëse ka mundësi që në këtë rregullore të shkollës me u cek detyrat dhe përgjegjësit të mësuesve mbështetës sepse secila shkollë ka mësueses mbështetës edhe aty me u listu detyrat dhe përgjësit

Drejtori i Arsimit Muhamet Gjoka -sa i për ketë rregullores së shkollës është kompetence e shkollës me u rishiku, ajo duhet me u bazu në rregullore komunale për funksionim të institucioneve arsimore ndërsa sa i përket detyrave dhe përgjesive qoftë të asistentëve këto janë të rregulluara me udhëzim administrativ është edhe numri i mungesave për nxënësve ne e përcjellim edhe një herë me i parë të gjitha shkollat i kanë në harmoni me rregulloren komunale për funksionimin e institucioneve arsimore dhe a ka nevojë me u rishiku specifikisht në shkollën ku po e cekni ju por çdo gjë ne e bëjmë në bazë të legjislacionit në fuqi.

Valentina Leku –edhe një kërkesë a ka mundësi që kujdestarët e klasave me u bërë obligative për me u mbajte kujdestari ketë pyetje nuk po e bëje unë por janë pyetje të mbledhura që kam sjell deri këtu me u bërë obligim dhe me u pagu sepse mungesa e mbajtës të orëve të kujdestarisë është shtimi i problemeve të nxënësve në shkollë realisht është një rregull që thotë që duhet me u mbajte po me qenë me vendim me u mbajte patjetër orëve e kujdestarisë

Drejtori i Arsimit Muhamet Gjoka -edhe kjo është e rregullume me kontrat në kuadër të detyrave dhe përgjesive, e di që disa e kanë kontestuar ndoshta ka edhe ne aspektin ligjor edhe avokat kanë kërkuar orë shtesë për mbajtjen e orëve të kujdestarisë në kuadër të ministrisë se arsimit është diskutuar që të paguhet të rregullohet me udhëzim administrativ dhe të hyn në kuadër të fondit të orëve që i kanë mësimdhënësit është duke u punuar në këtë drejtim por ende nuk është definu specifikisht po flas për pjesën me u vendos në kuadër të normave të rregullta mësimore, mirëpo sa i përket detyrave dhe përgjegjësive janë të obliguar me mbajte ore të kujdestarisë kuptohet për mësimdhënës që janë të rregullt më bazë në shkolle ,sepse një mësimdhënës mund të punojë në disa shkolla dhe nuk është i obliguar në të gjitha shkollat më mbajte edhe kujdestari.

Mehdin Salihu –një pyetje për Drejtorin e infrastrukturës Endrit Gllareva një kërkesë e qytetarëve rrugës prapa kedsit aty Fatime Hetemi a është në plan për rregullimi i saj sepse është në gjendje të mjerueshme?

Drejtorin e infrastrukturës Endrit Gllareva- po në plan është vetëm në vlerësim e kemi kontratën deri sa të përfundojnë procedurat edhe pastaj fillojmë .

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci – në mbledhjen e jashtëzakonshme pas miratimit të listës paraprake të dhënies së pronave dhe debateve të disa asamblastëve të opozitës gjeja se ne i kemi dhanë 51 prona nuk është e vërtetë ,ligjërisht komuna e ka obligim me i shpallë pronat edhe me i tregu publikut së cilat prona i ka të mundshme në shfrytëzim në interes të komunës por edhe në interes të investitorë ,ju e dini që ka kërkesa të investitorëve si është i për panele solare dhe përpunimit të mishit të rosave ,unë do të ja dërgoj një listë të bizneseve vendore dhe ndërkomtare që janë të interesuar për marrjen e pronës në shfrytëzim, nëse jeni të pajtimit në mund të caktojmë një komision negociues nga të gjitha grupet kuvendare të komunës tonë ,në qoftë së nuk e shihni të arsyeshme nuk formojmë komision ,ndërsa prona brenda qytetit as nuk e kam ndërmend më hapë as nuk e kam pasur kushdo që thotë nuk ju kanë votu pronat mashtrojnë opinionin përkohësisht por jo përgjithmonë sepse edhe pronat që i kemi jep i ka vlërsu pas aplikimit për marrjen e pronave as një vendim nuk keni ardh me marrë sepse keni prit me bërë pazare por me mua pazare për pronën publike nuk ka.

Egzona terdevci-mua po me vjen mirë që me në fund paske vendos me i ndarë bizneset qe janë të interesuara me marrë toka se ne ,këtë ta kemi kërkuar moti qysh në Janar kur i ke sjell pronat si asamblast kemi kërkuar me ditë cilat janë bizneset që janë të interesuar me marrë prona në Drenas, me herët e the një të pa vërtetë që ka pas prona në qytet në javën e kalume ju vet me propozim të grupit të PDK që i hjekt pronën e komunës së vjetër objektin e Çerdhes dhe parcelën e 743/30 qysh s'ka pas prona në qytet në liste s'po e kuptojë ku po e nxjerr përfundimin nëse tri prona janë hjek vet nga ju, edhe sa i përket të punësuarve nëse kish ndodhe në realitet kjo ish kanë shumë e mirë asnjëherë nuk e kemi marr një raport për pronat që janë dhanë deri tash që i kanë realizu premtimet aq sa i kanë premtu unë kam kërku edhe qasje në dokumente publike mi kanë dërgu qiratë edhe informata të tjera por kurr një raport për numrin e të punësuarve në këto ndërmarrje .

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci-nuk kam thënë as nuk thash që nuk ka pasur prona ,thashë se kam ndërmend me dërgu këtë vite prona pra asnjëherë prona të çerdhja nuk ka qenë shpallje publike sa për pronën të objektet e vjetra është në listë paraprake ,dhe në listë paraprake i kemi shumicën e pronave të identifikomë që mundën me qenë në shërbim të bizneseve në të mirë të qytetarëve të komunës tonë.

Egzona Terdevci- pjesa e presionit është e pa vërtetë se asamblastëve i është bërë presion në vazhdimësi nuk me është bërë mua unë asnjëherë nuk kam pas presion prej askujt sepse i kam shumë të qarat qëndrimet e mija, të tjerët kanë pas po le të flet secili për veti unë s'po merrem me askënd, e di shume mirë qa është lista paraprake po na e kemi si komunë listën e veçantë të pronave listën e përgjithshme të pronave çka vjen për vendim para paraprak ajo dihet se ka me u dhanë në shfrytëzim nëse nuk ka pasur me u jep në shfrytëzim atëherë çka ke ajo shou i javës se kaluar me i hjek ato tri prona, po i hani fjalët e juaja brenda dhjetë ditë .

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci-unë nuk e ndali zhvillimin e komunës për një pronë prona për të cilën , s'keni drejt me fol askush se nuk jeni ardh me votu kundër.

Mërgim Pirraku- a mundesh më e sqaruar që ne nuk kemi dashtë me përfitu, se është akuzë shumë e rëndë me gjithë respektin që mundem me pas për ty kjo mua me prek dhe nuk është në rregull, po dua të them se mua s'me ka thirrur askush prej pozitës për me ardh me votu asnjë pikë.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci – unë e di Mërgim që je djalë i pastër .

Pasi nuk pati me diskutime vërejtje dhe sugjerime mbledhja përfundoi ne orën 11:30

Me gjerësisht, mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Drenasit të datës 30.09.2024 mund të ndiqni në ueb faqen zyrtare të komunës, rrjetin social të Facebook-ut dhe në kanalin YouTube https://fb.watch/vfeXBqeJ_/


Procesmbajtëse:



Fakete Hoti



Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Gani Krasniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



Nr 01-020/04-99673 dt. 10/10/ 2024

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, në bazë të nenit 12 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 13,14 dhe 15 e Rregullores (QRK) nr:19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IAAP) të arsimit parauniversitar, si dhe rekomandimit të DKA-së në Drenas, Kuvendi i Komunës së Glogocit në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2024, të aprovoi këtë:

P R O P O Z I M V E N D I M

Për caktimin e anëtarëve të komisionit përzgjedhës për Drejtor në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore të Komunës së Drenasit

Neni 1

Më këtë Propozim Vendim caktohen anëtarët e komisionit përzgjedhës për Drejtor dhe Zëvendës drejtor në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore të Komunës së Drenasit, si vijon:

1. Arbesa Islami Dobra – Fakulteti Filozofikë – Pedagogji e Përgjithëshme (180 ECTS + Master – Pedagogji e Përgjithshme (120 ECTS).
2. Arben Haziri – Ma.sc. Gjuhë Shqipe (Këshilli i Prindërve);
3. _____ - Anëtar nga MASHTI.

Neni 2

Ky komision ka për detyrë që procedurat e përzgjedhjes së drejtorëve t'i zhvilloj në përputhje me Rregullores (QRK) nr:19/2024 të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

Neni 3

Mandati i anëtarëve të komisionit nga DKA për Drejtor në Institucione Arsimore përfundon me nxjerrjen e vendimit/eve përfundimtare/e për përzgjedhjen e kandidatit/ëve në pozitën/at e kërkuara me konkurs.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës.



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Komuna e Drenasit

Zyra e Kryetarit

01- Nr 030/01- 49607 dt. 09/10/2024

DRAFT PROPOZIM

STRATËGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2025 - 2029

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (i) të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gaz.Zyrt. e Republikës së Kosovës"), nenit 34.6 pika të Statutit të Komunës së Drenasit; me nr; 01-110-6904 të dt; 24.09.2008, Dispozitave të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr. 07/2018 për Planifikimin Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit, në bazë të nenit 4 paragrafi 2 të Ndryshim Plotësimi i Statutit të Komunës së Drenasit me nr: 12-030-19523 të dt;06.04.2018, dispozitave të Udhëzimit Administrativ NR.04/2018 për Transparencën në Komuna, dispozitave të Udhëzimit Administrativ NR.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, dispozitave të Rregullores Nr.01/2017 për Procedurat e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës, dispozitave të Rregullores (QRK)Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, dispozitave të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datën _____ të aprovoj:

STRATËGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2025-2029

Ky dokument strategjik përcakton objektivat dhe veprimet e planifikuara komunale që duhet të ndërmerren në fushat të ndryshme të ndërlidhura me politikat të cilat adresojnë problemet e caktuara për periudhen kohore 2025-2029.



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci